

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 419, DATË 26.6 2024 , TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E VLERAVE TË
SECILIT ELEMENT PËRBËRËS TË PAGËS BRUTO MUJORE TË
PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE
SHPËTIMIN”**

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka si qëllim realizimin e indeksimit dhe rritjes së pagave për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në zbatim të kompetencës së Këshillit të Ministrave për të miratuar masën e indeksimit dhe rritjet e pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi hartohet si pasojë e detyrimit ligjor që ka Këshilli i Ministrave për të miratuar masën e indeksimit dhe rritjet e pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi i paraqitur është hartuar në bazë të përcaktimit të dhënë në shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 8, ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, për zbatimin e kompetencës që ka Këshilli i Ministrave për të miratuar rritjet e pagave dhe masën e indeksimit të pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike.

Indeksi i pagave për vitin 2026 bazohet në indeksin e ndryshimit të çmimeve të konsumit, të deklaruar/shpallur nga qeveria shqiptare në masën 2.5% dhe do të realizohet për të gjithë punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Nëpërmjet këtij projektvendimi realizohet indeksimi në masën 2.5% i elementit të pagës bruto mujore “paga për gradë”, si dhe një politikë e diferencuar e rritjes së vlerës së pagës për gradë, për punonjësit e nivelit bazë, duke bërë që pagat për gradë të punonjësve të këtij niveli të rriten nga 5% deri në 8.33%. Ndërkohë meqenëse llogaritja e elementit tjetër të pagës bruto mujore, “shtesa për vjetërsi në punë”, aplikohet mbi pagën për gradë, automatikisht edhe ky element rritet me 8.33%.

Ndryshimet e vlerave të pagës për gradë, reflektohen në lidhjen nr. 1, të vendimit aktual nr. 419, datë 26.06.2024, ku nëpërmjet indeksimit dhe rritjes për punonjësit e nivelit bazë, për gradën “Asistent Zjarrfikës” arrin në vlerën 5,000 lekë në muaj dhe për gradën “Kryeinspektor Zjarrfikës”, në vlerën 3,000 lekë në muaj. Për më tepër ndryshimi i pagave bazë për gradë paraqitet në tabelën si vijon:

Grada	Paga për gradë aktuale	Paga për gradë e rritur
Asistent Zjarrfikës	60,000	65,000
Zjarrfikës	65,000	69,000
Kryezjarrfikës	70,000	73,500
Inspektor Zjarrfikës	75,000	78,000
Kryeinspektor Zjarrfikës	85,000	88,000
Komisar Zjarrfikës	105,000	108,000
Drejtues Zjarrfikës	115,000	118,000
Drejtues i Parë Zjarrfikës	140,000	143,500
Drejtues i Lartë Zjarrfikës	160,000	164,000

Nga miratimi i këtij projektvendimi përfitojnë rreth 1200 punonjës të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në nivel qendror dhe në nivel vendor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të:

- nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Ky projektvendim propozohet nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe ka 4 pika dhe 1 (një) lidhje bashkëlidhur që propozojnë sa vijon:

Pika e parë: përcakton zëvendësimin e lidhjes nr. 1, të vendimit aktual;

Pika e dytë: përcakton që vlerat e elementit “paga për gradë”, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe politikës së rritjes së pagave për punonjësit me gradën “Asistent zjarrfikës”, “Zjarrfikës”, “Kryezjarrfikës”, “Inspektor zjarrfikës” dhe “Kryeinspektor zjarrfikës” dhe rezultat i indeksimit në masën 2.5% për gradat e tjera;

Pika e tretë: përcakton përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2026;

Pika e katërt: përcakton institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në nivel qendror, dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, që kanë strukturat përkatëse të këtij shërbimi.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Ky projektvendim është hartuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe është dakordësuar në fazën e përgatitjes së tij me përfaqësues të ministrisë së Financave.

RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare të miratimit të këtij projektvendimi, për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore, sipas llogaritjes nga ana e ministrisë përgjegjëse për financat rezultojnë rreth 6.7 milion lekë në muaj.

Efektet financiare të llogaritura si më sipër, për vitin 2026, do të përballohen nga nga buxheti i institucioneve përkatëse, të miratuara në ligjin 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”. Për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përballohen nga transfertat e miratuar në ligjin 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, si dhe nga të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore.

PROPOZUESI
MINISTRI I SHTETIT
PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTI-KORRUPSIONIN
ADEA PIRDENI

